

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me gjyqtari Gëzim Pozhegu me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit : P. Th. nga fsh. T., K. e Prizrenit, për shkak të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, të akuzuarve Gj. Ll. nga fsh. D. K. e Gjakovës dhe P. P. nga fsh. T., K. e Prizrenit, për shkak të veprës penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/I.nr.71/2014 të datës 10.10.2014, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 20.02.2017, në praninë e prokurorit të shtetit Agron Matjani, të akuzuarit P. Th. dhe mbrojtësi të tij N. D. avokat nga Gjakova, me datë 20.02.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P. TH.**, i biri i Gj. dhe nenës P., e gjinisë B., i lindur me ... në P., tani me banim në fshatin T., K. e Prizrenit, me nr. personal..., ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në firmë private si agjent i shitjes, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

Është Fajtor

Për shkak se :

Më datë 10.02.2014 rreth orës 14:30 minuta në Gjakovë pikërisht në Stacionin e autobusëve ka përdorur armën pistoletën me ngjyrë të zezë në mënyrë kërcënuese ndaj të dëmtuarit D. H. në atë mënyrë, pasi që axha i tij P. Th. ka pasur një mosmarrëveshje me të dëmtuarin e lartpërmendur, i akuzuari ka nxjerrë pistoletën e ka vu në kokën e të dëmtuarit dhe të njëjtin e ka grushtuar, me çka i shkakton lëndime të rënda trupore.

- me çka ka kryer veprën penale: Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform neneve 6,17 par. 1,41,43, par. 3, 46, 51, 73, 74, 75 nenin 375 par. 2 dhe 3 të KPRK-së, si dhe neneve 450 par. 1 dhe 2, 359 par.2 dhe 366 të KPRK-së, të akuzuarin e,

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 300.00 € (treqind euro)

dhe

ME DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 1 (NJË) VITI, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qese i akuzuari në afatin e verifikimit prej dy (2) viteve, nuk kryen vepër tjetër penale.

Dënim me gjobë në shumën prej 300.00 € (treqind euro), shumë të cilën obligohet t' a paguajë në afat prej 15 ditësh pasi që ky Aktgjykim të merr formë të prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet brenda afatit të paraparë atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga 20 €, (njëzet euro).

Në kuptim të nenit 450 par.1, 2 të KPPK-së, i dënuari obligohet në pagesën e shpenzimeve të paushallit gjyqësor në shumën prej 25 €, si dhe në emër të shpenzimeve gjyqësore shumën prej 25 €, të cilat shuma duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 375 par. 3 të KPRK-së, të konfiskohet pistoleta me ngjyrë të zezë, si objekt i kryerjes së kësaj vepre penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me aktakuzë PP/I.nr.71/2014 të datës 10.10.2014, ka akuzuar P. Th. nga fsh. T., K. e Prizrenit, për shkak të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, të akuzuarit Gj. Ll. nga fsh. D., K. e Gjakovës dhe P. P. nga fsh. T., K. e Prizrenit, për shkak të veprës penale: Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor fillestar të mbajtur më datë 20.02.2017, prokurori i shtetit para se të lexojë aktakuzën propozon që ndaj të akuzuarve Gj. Ll. nga fsh. D., K. e Gjakovës dhe P. P. nga fsh. T., K. e Prizrenit, të bëhet veçimi i procedurës për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës.

Në këtë shqyrtim fillestar të mbajtur më datë 20.02.2017, në praninë e Prokurorit të shtetit Agron Matjani, të akuzuarit i' u është lexuar aktakuza, i akuzuari ishte deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe Gjykata është e bindur se i akuzuari P. Th., e ka kuptuar aktakuzën, si dhe të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë.

Me këtë rast, Gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPRK-së, kështu që pas konsultimeve të bëra me mbrojtësin e tij

av. N. D., i akuzuari P. Th., ka deklaruar se e kupton aktakuzën dhe deklaroi se ndihet fajtor dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas deklarimit të të akuzuarit P. Th., për pranimin e fajësisë Kryetari i trupit Gjykes kërkoi që mendimin e vetë t' a jap edhe Prokurori i Shtetit Agron Matjani, i cili deklaroi se : nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqenëse i njëjti pasi që u njoftua nga Gjyqtari për favorin e pranimin të fajësisë, në mënyrë të vullnetshme pa ndikim të askujt u deklarua se e pranon fajin, andaj Gjykata këtë pranim të fajësisë t' a merr si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit. Njëherit propozojë që të bëhet konfiskimi armës dhe municionit në kuptim të nenit 375 par.3 të KPRK-së.

Lidhur me pranimin e fajësisë mbrojtësi i të akuzuarit P. Th., avokati N. D. nga Gjakova deklaroi se : se nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, meqenëse i njëjti është konsultuar me mua dhe se në bazë të provave të cilat janë bashkangjitur aktakuzës dhe deklarimit të tij të dhënë me vullnet të lirë, pa ndikim të askujt, edhe neve nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim.

Në vijim Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, vlerësojë se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe në mbështetje të fakteve të propozuara në aktakuzë, konform nenit 326 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 të KPRK-së si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk u zbatua procedura e provave dhe fjala përfundimtare.

I akuzuari P. Th., deklaroi se e ndien veten të penduar thellësisht dhe premti se nuk do të përsërisë një veprë të tillë në të ardhmen.

Nga gjendja faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij Aktgjykimi pa dyshim rrjedhë se në veprimet e të akuzuarit P. Th. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale : Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do të zvogëlonin ose përjashtonin përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.5/3, të KPRK-së.

Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin P. Th. Gjykata mori gjendjen e dobët ekonomike, se është mbajtës i vetëm i familjes, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer penale dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale, pranim që sipas vlerësimit të Gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij, e duke i vlerësuar këto rrethana lehtësuese konform

nenit 73, 74 dhe 75 të KPK-së të akuzuarin e gjykon si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilin do të arrihet dhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur të shoqërisë.

Gjykata po ashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do t'i shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, dhe ky dënim do të ketë efekt preventivë gjeneral për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par.1 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes së këtij aktgjykimi gjyqtari i udhëzojë palët me të drejtë ankese, se mund t' a parashtronë në përputhje me nenin 368. par.1 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë
PKR.nr.206/2014 me datë 20.02.2017.**

Sekretarja juridike

Arbënore Basha

Kryetari i trupi gjykues-Gjyqtari

Gëzim Pozhegu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër aktgjykimit lejohet ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes të kësaj gjykate.